



REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr Prot.	
Dep.	25/DPK	Br Prot.	01-994/16
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	Date	04-03-2016
Nr. pages			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.03.2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4645/15, për z. Asdren Gashi – Ministër Këshilltar në Ambasadën e Kosovës në Zagreb, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4645/15, për z. Asdren Gashi – Ministër Këshilltar në Ambasadën e Kosovës në Zagreb, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “GMG Consulting”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

z. Gashi është njoftuar se nuk mund të ushtroj në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë në biznesin privat, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit duke caktuar një person të autorizuar.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar biznesin privat “GMG Consulting”. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

